

Elezaj dhe Prebreza
i japin mbështetje
marshit "Drejtësi,
jo politikë" | F. 4



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



NIS NUMËRIMI MBRAPSHT: ÇFARË MUND TË NDODHË ME POZITËN E PRESIDENTIT?

F. 4-5



Ani pse është demokraci parlamentare, në Kosovë ka pasur gjithmonë rëndësi se kush është ngjitur në pozitën e

presidentit. Mandati i radhës nuk përbën asnjë dallim. Madje kalkulimet për të duket që sa shkojnë e rriten. Në anën tjetër,

koha për finalizim të procesit sa shkon e shkurtohet. Pse, atëherë, partitë nuk deklarohen zëshëm për një kandidat?

**"RRITJA E ÇMITIT
TË RRYMËS NA
VARFËRON": RINIA
E PDK-SË ME
FATURË GJIGANTE,
ALARMON PËR
RRITJEN 21 %** F. 7



**SI U SHNDËRRUA GAZA NË DEBAT
TË BRENDSHËM NË KOSOVË** F. 3



AKTUALE



**RAMA TAKOHET ME PAPA LEON XIV,
FLASIN PËR ÇËSHTJET E
BALLKANIT DHE INTEGRIMIN NË BE**

F. 2

**SHBA-ja MIRATON FONDE
PËR SHITETET BALTIKE TEKSA
RUSIA TESTON KRAHUN
LINDOR TË NATO-S** F. 2

**PSE OSMANI PO PARALAJMËRON
NDJEKJE LIGJORE NDAJ
GAZETARIT TË FAZ-it?** F. 7

EKONOMI



**GUVERNATORI ISMAILI PRET
MISIONIN E FMN-së PËR
KONSULTIMET E NENIT IV TË
MARRËVESHJES ME FMN-në** F. 8

SPORT



**ADEMI RIZGJEDHET PRESIDENT I
FFK-SË: VOTA JUAJ, VLERËSIM I
PUNËS SË BËRË BASHKËRISHT** F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja MIRATON FONDE PËR SHTETET BALTIKE TEKSA RUSIA TESTON KRAHUN LINDOR TË NATO-s

UASHINGTON, 5 SHKURT - Kongresi i Shteteve të Bashkuara e ka miratuar një fond prej 200 milionë dollarësh si asistencë sigurie për shtetet e Baltikut teksa shtohet aktiviteti rus në krahun lindor të NATO-s.

Fondet, që janë miratuar këtë javë në kuadër të shpenzimeve për vitin fiskal 2026, garantojnë fonde për Estoninë, Letoninë dhe Lituani nën Iniciativën për Siguri të Baltikut.

Paketa prej 838.7 milionë dollarëve, e nënshkruar nga presidenti amerikan Donald Trump, më 3 shkurt, parasheh rritje të bashkëpunimit me tri shtetet baltike, pavarësisht prej përpjekjeve të kaluara të Pentagonit për t'i eliminuar ato.

Rreth 10 milionë dollarë shtesë i janë ndarë Estonisë nga programi për financim të ushtrive të huaja, fonde të cilat Tallini i ka përdorur më parë për të blerë pajisje HIMARS, raketa Javelin dhe predha artilerie të kalibrit të madh. "Ky është parandalim shumë i mirë për aleatët tanë të Baltikut", ka thënë kongresisti Don Bacon



në disa përgjigje për Radion Evropa e Lirë.

Ai ka thënë se kjo çështje është kthyer në prioritet pasi Departamenti Amerikan i Mbrojtjes* ka dhënë sinjale për ndalje të fondeve për programin. "Kongresi është i përkushtuar për aleancë të fuqishme të NATO-s dhe ne e dimë që duhet vëmendje më e madhe sa i përket Baltikut", ka thënë ai, duke shtuar se

historia është dëshmi për rrezikun që kanoset nga braktisja e angazhimeve globale. "Shumica në Kongres janë të përkushtuar për NATO-n dhe ne e dimë që kemi nevojë për miq për ta luftuar Kinën, Rusinë dhe Iranin. Nuk mund ta bëjmë vetë. Amerika vetëm është një Amerikë e dobësuar", ka thënë Bacon.

Tri shtetet baltike, të gjitha anëtare të NATO-s dhe

mbështetëse të Ukrainës, kanë parë shkelje të hapësirave të tyre territoriale nga aeroplanët dhe dronët rusë në muajt e fundit.

Bacon ka thënë se lufta e Rusisë kundër Ukrainës, që shpejt po hyn në vitin e pestë, është kërcënim përtej kufijve të Ukrainës. Ai ka thënë se mënyra se si përfundon konflikti, më i përgjakshmi në Evropë prej përfundimit të

Luftës së Dytë Botërore, do të formësojë ambientin e sigurisë për shtetet baltike dhe fqinjët tjerë më të brishtë. "Nëse Ukraina humb, atëherë duhet ta dimë që Moldavia do të jetë e radhës", ka thënë ai. "Ne nuk duhet të jemi neutralë. Ne duhet të qëndrojmë në anën e lirisë dhe kundër një banditi diktator". Për shtetet baltike miratimi i fondeve shkon përtej vendimeve buxhetore.

Ministri i Jashtëm i Lituaniës, Kestutis Budrys, i ka thënë Radios Evropa e Lirë më 4 shkurt se vendimi vërteton se ky rajon përbën linjën e frontit të NATO-s.

Budrys i ka përmendur edhe rreziqet e tjera që i kanosen rajonit, përfshirë operacionet hibride ruse dhe bjelloruse.

Kristen Taylor, nga Iniciativa për Siguri Transatlantike në Këshillin Atlantik, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se legjislacioni është miratuar në kohën e urgjencës në rritje, për shkak të aktivitetit rus. Sipas saj, ky financim është miratuar për t'i rritur kapacitetet ushtarake për aleatët e Baltikut.

RAMA TAKOHET ME PAPA LEON XIV, FLASIN PËR ÇËSHTJET E BALLKANIT DHE INTEGRIMIN NË BE

VATIKAN, 5 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të enjten ka zhvilluar një takim me Papa Leon XIV. Gjatë këtij takimi Rama ka qenë i shoqëruar nga bashkëshortja, Linda Rama dhe djali i tij. Sipas një deklarate me shkrim nga Vatikani, Papa priti kryeministrin Rama mëngjesin e së enjtes në Vatikan, më pas u zhvillua një takim në Sekretarinë e Shtetit të Selisë së Shenjtë me kardinalin Pietro Parolin dhe sekretarin për Marrëdhëniet me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare (Ministri i Jashtëm), kryepeshkopin Paul Richard Gallagher.

Në deklaratën e Vatikanit u nda informacioni se "gjatë diskutimeve të përzemërta, u vu theksi në marrëdhëniet e mira dypalëshe midis dy vendeve, si dhe u trajtuan çështje me interes të përbashkët në lidhje me marrëdhëniet midis kishës dhe shoqërisë civile në vend". "Takimi u përqendrua gjithashtu në çështjet kryesore rajonale, duke përfshirë



situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe rrugën e Shqipërisë drejt integrimit të plotë në Bashkimin Evropian", thuhet në deklaratë.

Rama, po ashtu, ka vizituar edhe bazilikën e famshme, ku gjendet shëmbëlltyra e Zojës së Këshillit të Mirë, mbi një copë të shkëputur nga muri i Kishës së Shkodrës në vitin e largët 1467. "Që nga ajo kohë asnjë kryetar shteti ose qeverie shqiptare nuk e kishte shkelur pragun e bazilikës, ku krah Zojës së Shqipërisë qëndron përherë edhe flamuri ynë kombëtar, e ku kanë kryer vizita e rite thaujse të gjithë Papët e

Romës. Gjëja e parë që bëri edhe Papa Leoni XIV sapo u zgjodh, ishte të vinte e të lutej në Genazzano te Zoja e Këshillit të Mirë, e cila thirret edhe Regina di Albania - Mbretëresha e Shqipërisë", ka theksuar Rama.

Kryeministri Rama ka bërë homazhe edhe te varri i Papa Françeskut, të cilin e ka quajtur mik të paharruar të Shqipërisë dhe të familjes së tij. "Nuk harronte kurrë të lutej për popullin tonë e të na dërgonte mesazhet e tij të miqësisë, ishte një çast i veçantë i vizitës në Selinë e Shenjtë", ka deklaruar Rama.

SI U SHNDËRRUA GAZA NË DEBAT TË BRENDSHËM NË KOSOVË

PRISHTINË, 5 SHKURT - Edhe pse Kosova ndodhet rreth 1 800 kilometra larg Gazës, konflikti i armatosur atje shkaktoi jehonë të fortë në debatet publike dhe rrjetet sociale vendase - nga sharjet dhe ofendimet deri te kërcënimet me jetë. Ngjarjet e 7 tetorit 2023, kur militantë të Hamasit - grup i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe fuqi të tjera - kaluan kufirin me Izraelin, vranë mbi 1 200 njerëz dhe rrëmbyen qindra të tjerë, shkaktuan një krizë humanitare në enklavën e kontrolluar nga Hamasi, që vazhdon ta tronditë botën. Mbi dy vjet më vonë, pas ndërmjetësimit të presidentit amerikan Donald Trump, Izraeli dhe Hamasi bënë një armëpushim të brishtë, por pasojat e dhunës mbeten të thella: rreth 70 mijë palestinezë të vrarë në Gazë dhe një botë e ndarë midis viktimave dhe sulmuesve nga të dyja anët. Në këtë kontekst, debatet në Kosovë, të cilat vazhdonin që nga fillimi i konfliktit, u shtuan javën e kaluar pas publikimit të një dokumentari nga gazetari Kushtrim Sadiku. Po, përse ky polarizim?

Kërcënimet ndaj gazetarit dhe reagimet publike

Tri ditë para publikimit të dokumentarit në Televizionin Kanal 10 - i cili rikthen ngjarjet e 7 tetorit përmes rrëfimeve të të mbijetuarve dhe analizës së situatës në Izrael, mbi dy vjet më vonë - Sadiku filloi të përballej me reagime të ndryshme lidhur me përmbajtjen. Pas publikimit, mesazhet kërcënuese rritën shqetësimin e tij dhe të familjes. “Kam marrë kërcënime për jetën të cilat i kam adresuar te Policia dhe Prokuroria e Kosovës. Gjithashtu, kam njoftuar edhe disa ambasada mike”, deklaroi Sadiku për Radion Evropa e Lirë. Debat i në televizionet vendore dhe rrjetet sociale u ndez menjëherë. Opinjonistë dhe qytetarë morën qëndrime mbështetëse ose kritike, ndërsa komentet shpesh kaluan edhe në tone të ashpra.

Çfarë thotë ligji në Kosovë?

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës thuhet se “nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe mosdurimt midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”. Gazetari Sadiku konfirmon për REL-in se rasti i tij po hetohet nga prokuroria.



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) reagoi, duke kërkuar që diskutimi të zhvillohet brenda kornizave të debatit të lirë, pa kërcënime ndaj sigurisë personale.

Rrjetet sociale, terren i polarizimit

Për njohësit e fushës, gjërat nuk janë thjeshta. Profesori i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Alban Zeneli, thotë se konflikti izraelito-palestinez është ndër më të mediatizuarit në botë dhe shton se rrjetet sociale në Kosovë janë ato që përdoren si mjet për përçarje. “Komentet nuk filtrohen, debati nuk organizohet, ndërsa përçarja shfrytëzohet për audiencë dhe shikueshmëri. Televizionet vendore shpesh i amplifikojnë këto tensione përmes fragmenteve të emisioneve të tyre në rrjetet sociale”, thotë Zeneli për Radion Evropa e Lirë. Ky model i “ekonomisë së vëmendjes”, sipas tij, sjell pasoja reale: debatet emocionale tejkalojnë analizën objektive dhe argumentet racionale, duke amplifikuar ndasitë brenda shoqërisë. “Unë mendoj se kjo është e lidhur direkt me mënyrën se si po bëhet biznes me median në Kosovë, sepse monetizimi i përmbajtjeve nga mediat sociale e krijon këtë lloj të

logjikës së përplasjes. Në modelin e biznesit të vetë mediave sociale, dominon ekonomia e vëmendjes, pa të cilën këto platforma nuk janë të vlefshme”, shton ai.

Reagimet historike dhe fetare

Profesori i Historisë në Universitetin e Prishtinës, Mentor Hasani, vlerëson për Radion Evropa e Lirë se përfshirja e Kosovës në këtë debat lidhet me shumë faktorë - historikë, fetarë, politikë e gjeopolitikë. Sipas tij, Ballkani - përfshirë Kosovën - ka qenë historikisht pjesë e perandorive me shtrirje globale, ku janë formësuar identitete të ndryshme fetare, kulturore dhe sisteme vlerash që ndikojnë edhe sot në leximin e konflikteve ndërkombëtare. Ai thotë se për shqiptarët e Kosovës, kujtesa e luftës, dhunës dhe spastrimit etnik mbetet e freskët, edhe gati 27 vjet pas përfundimit të saj. Kjo përvojë, sipas tij, reflektohet drejtpërdrejt në reagimet ndaj konfliktit në Gazë, ku individë dhe grupe të ndryshme shfaqin empati ose mirëkuptim për njërin apo tjetrën palë. “Njerëzit e lexojnë konfliktin përmes përvojës personale - kush është viktimë, kush agresor, kush ka pushtet dhe kush është i pambrojtur - çka shpesh çon në vlerësime të pasakta”, sipas tij. Hasani shton se reagimet në rrjetet sociale, veçanërisht ato në mbështetje të palestinezëve, përveç empatisë ndaj viktimave, bartin edhe një dimension fetar. Edhe pse në Kosovë vazhdon të dominojë një islam tradicional, ai paralajmëron për ekzistencën e grupeve periferike që predikojnë forma radikale të fesë dhe nxisin përplasje brenda komunitetit. “Ky emocionalitet i ushqyer nga

pamjet e dhunës në Palestinë, ka krijuar hapësirë për instrumentalizim dhe përhapje të ideve radikale, duke lënë edhe përshtypjen e një antisemitizmi në nivele të caktuara”, thekson Hasani. Megjithatë, ai vëren se në debatet publike ka edhe qëndrime mbështetëse për Izraelin, të cilat i sheh si strategjike dhe pragmatike. “Këta njerëz e shohin këtë mbështetje si pjesë të orientimit drejt Perëndimit dhe fuqive të mëdha, që kanë luajtur rol vendimtar në mbijetesën e popullit dhe shoqërisë sonë”, thotë Hasani.

Përplasjet online dhe emocionet

Për psikologun Dashamir Bërxulli, përplasjet online janë shpesh amplifikim i emocioneve historike dhe fetare. Individët ose grupet me orientim fetar mbështesin kauzën palestineze, ndërsa të tjerët, me orientim historik, mbështesin Izraelin, sipas tij. Ai paralajmëron se polarizimi i tillë mund të sjellë tension edhe në jetën reale, nëse nuk menaxhohet me kujdes nga elitat politike dhe intelektuale. “Unë nuk po them se (polarizimi i shoqërisë) do të kulmojë në veprime të caktuara. Por, me gjasë, kur një tullumbace me energji mblidhet, atëherë - në një mënyrë ose tjetër - do të shpërthejë”, thotë Bërxulli për Radion Evropa e Lirë.

Edukimi dhe dialogu si zgjidhje

Historiani Mentor Hasani vlerëson se në parandalimin e thellimit të polarizimit shoqëror, rol të rëndësishëm mund të luajnë përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme, përfshirë ato fetare. Duke iu referuar të dhënave të

Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sipas të cilave mbi 93 për qind e qytetarëve deklarohen të besimit islam, Hasani thekson se Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) mund të ketë ndikim kyç në shtendosjen e përplasjeve publike, veçanërisht në rastet kur përdoret fjalor me ngjyrim antisemit nga grupe me qëndrime radikale. “Bashkësia Islame e Kosovës mund ta luajë një rol të madh, ashtu siç e ka luajtur viteve të fundit përballë këtyre rrymave”, thotë ai. Radio Evropa e Lirë i është drejtuar BIK-ut për koment lidhur me këto polarizime, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Në anën tjetër, diplomati i Kongresit Botëror Hebre për Kosovën, Flori Zevi, vlerëson për Radion Evropa e Lirë se debatet rreth Gazës janë tregues i qartë i nevojës për më shumë edukim medial, qasje ndërdisiplinore dhe dialog të përgjegjshëm publik. Sipas tij, dokumentari i gazetarit Sadiku ka hapur një diskutim të domosdoshëm, por reagimet ndaj tij dëshmojnë vështirësinë e shoqërisë për të ndarë faktet nga emocionet dhe analizën nga pozicionimi ideologjik. Zevi thotë se në diskursin publik po zbehen zërat që kërkojnë paqe dhe dialog, ndërsa po dominojnë slogane që, në kontekstin e tyre historik dhe ideologjik, mohojnë të drejtën e Izraelit dhe të popullit hebre për ekzistencë. “Kur kritika politike shndërrohet në demonizim kolektiv, atëherë kemi kaluar kufirin nga debati legjitim në diskriminim dhe urrejtje etnike apo fetare. Pikërisht për këtë arsye, edukimi është kyç”, thotë Zevi. Paqja nuk ndërtohet me slogane shkatërruese, por me empati, dije dhe përgjegjësi morale, përfundon Zevi.



PSE OSMANI PO PARALAJMËRON NDJEKJE LIGJORE NDAJ GAZETARIT TË FAZ-it?

PRISHTINË, 5 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, po konsultohet me avokatë në Gjermani për t'i përdorur të gjitha mjetet ligjore me qëllim që ta "mbrojë integritetin" e Presidencës dhe shtetit, pas një përplasjeje virtuale me një gazetar të së përditshmes "Frankfurter Allgemeine Zeitung" (FAZ). "Shpifja dhe pretendimet e pabaza dhe të rreme nga Michael Martens [i njohur si Andric1961] iu nënshtrohen përgjegjësisë civile dhe penale sipas ligjit gjerman. Presidentja Osmani i mohon në mënyrë kategorike pretendimet e tij shpifëse dhe përhapjen e rrezikshme të dezinformimit", ka shkruar në 'X' këshilltari i Osmanit, Rinor Nuhui. FAZ është themeluar më 1949. Është një e përditshme gjermane që gjerësisht konsiderohet si medie serioze dhe e besueshme. Gazetari i FAZ-it, Michael Martens, u kundërpërgjigj menjëherë për këtë paralajmërim, duke theksuar se punon që tri dekada në

fushën e gazetarisë dhe asnjëherë nuk është përballur me padi. "Kam punuar në shtete sikurse Rusia, Afganistani e Turqia, kam shkruar për oligarkët rusë, kriminelët e luftës nga Serbia, kontrabandistët e Malit të Zi, rebelët kurdë dhe asnjëherë nuk jam paditur. Por, tani...", ka shkruar ai në 'X'.

Pse ndjekje ligjore?

Reagimi i Nuhiut erdhi një ditë pasi FAZ-i publikoi një artikull për Osmanin, me titullin: "A është Osmani kandidate e Trumpit?" dhe në fillim të tij thuhet se Osmani - mandati i së cilës në krye të shtetit të Kosovës përfundon në mars - po synon edhe një mandat pesëvjeçar me ndihmën e familjes së presidentit amerikan, Donald Trump. Dhe kjo nuk është e gjitha. Në fund të janarit Osmani publikoi në X një video nga premiera e dokumentarit "MELANIA", e Zonjës së Parë të Shteteve të Bashkuara, Melania Trump, ku flitet për

familjen presidenciale. Gazetari Martens e ripublikoi këtë postim, ku shkroi: "A i ka thënë dikush presidentes në largim të Kosovës që është një vijë mes përfaqësimit të interesave legjitime të shtetit dhe prostitucionit intelektual vetëdegradues? Osmani duket se nuk është e vetëdijshme për këtë". Ai vazhdoi edhe në ditët e tjera të shkruante komente kritike për Osmanin, dhe më 4 shkurt shkroi se "gratë nuk janë inferiore ndaj burrave - ato janë të afta të bëjnë çfarëdo që bëjnë burrat. Ja e keni shembullin e Kosovës, ku presidentja Vjosa Osmani tregon se për hir të karrierës së saj politike ajo mund të jetë pa shtyllë kurriore po aq sa kolegët e saj burra". Radio Evropa e Lirë i është drejtuar zyrës së Osmanit për të kuptuar më shumë rreth masave ligjore të paralajmëruara dhe nëse subjekt i ndjekjes ligjore do të jetë vetëm gazetari apo edhe media ku ai punon, por deri në publikimin e këtij shkrimi nga Presidenca e Kosovës nuk

kanë kthyer përgjigje.

Çfarë u tha tjetër në FAZ për Osmanin?

Në artikullin e publikuar për Osmanin, më 4 shkurt, përmendet pjesëmarrja e Osmanit në Bordin e Paqes - nismën e presidentit Donald Trump për zgjidhjen e konflikteve në botë, që u jetësua në Forumin e Davosit. Kosova, e përfaqësuar nga Osmani, ishte ndër shtetet themeluese të këtij trupi ndërkombëtar. Martens, duke u thirrur në "informacione jozyrtare nga Prishtina", shkroi se Osmani e bëri këtë veprim pa u konsultuar me kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti. "Ishte kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, që pretendohet se ndërmjetësoi qasjen e Osmanit te Trumpi", shkroi ai. "Rama ka lidhje me familjen presidenciale amerikane sepse ai i ka dhënë dhëndrit të Trumpit, Jared Kushner kontratë multimiliardëshe për një

projekt në bregdetin shqiptar. Rama nuk ka raporte të mira me Kurtin", shkroi Martens. Në Davos ato ditë ishte edhe Kurti, por ai nuk mori pjesë në ceremoninë e Bordit të Paqes. Kur u pyet nga një medium në Shqipëri pse ishte ajo e jo Kurti në themelimin e Bordit, Osmani tha se në bazë të Kushtetutës, është presidenti që udhëheq politikën e jashtme. Më pas, në artikull përmendet mandati presidencial i Osmanit, që skadon në mars. Sipas artikullit, Osmani nuk ka mbështetje në Kuvendin e Kosovës për rizgjedhje. "Për të kompensuar mungesën e mbështetjes në Kosovë, që disa javë, Osmani po tenton ta paraqesë veten si 'kandidate të Trumpit'. Llogaritja: ShBA-ja është faktor kyç në Kosovë, jo vetëm përmes bazës ushtarake Bondsteel, por edhe përgjatë historisë së këtij shteti të ri, dhe ky karakterizim mund t'i sigurojë asaj një mandat të ri... Kërcënimi është: 'nëse s'më rizgjidhni si presidente, do të keni telashe me ShBA-në'".

NIS NUMËRIMI MBRAPSHT: ÇFARË MUND TË NDODHË ME POZITËN E PRESIDENTIT?

Ani pse është demokraci parlamentare, në Kosovë ka pasur gjithmonë rëndësi se kush është ngjitur në pozitën e presidentit. Mandati i radhës nuk përbën asnjë dallim. Madje kalkulimet për të duket që sa shkojnë e rriten. Në anën tjetër, koha për finalizim të procesit sa shkon e shkurtohet. Pse, atëherë, partitë nuk deklarohen zëshëm për një kandidat?

PRISHTINË, 5 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka thënë hapur se synon edhe një mandat në krye të shtetit, por disponimin e njëjtë nuk duket se e kanë ata që duhet t’ia japin votën. Momentalisht Kosova nuk e ka një legjislaturë të re në Kuvend, ndonëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka shpallur rezultatet përfundimtare dhe pritët t’i certifikojë ato shpejt. Ndërkohë, numërimi mbrapsht ka nisur: Deputetët duhet ta votojnë deri më 4 mars emrin e presidentit për mandatin e ri, në të kundërtën vendi i rrezikon edhe një palë zgjedhje të parakohshme.

Çfarë thonë partitë?

Për Lëvizjen Vetëvendosje (LV), partinë që ka fituar mbi 51 për qind të votave në parlamentaret e parakohshme të 28 dhjetorit, zgjedhja e presidentit përbën prioritetin e katërt. Kreu i saj, Albin Kurti, njëherësh kryeministër në detyrë i Kosovës, e ka pranuar se ka biseduar me Osmanin në këtë drejtim por, sipas tij, muaji shkurt e vërteton gatishmërinë dhe interesimin e opozitës për të nisur një kapitull të ri me pushtetin. Për Dritëro Arifin, njohës i çështjeve politike, LV-ja me qëllim nuk është deklaruar me “po ose jo të madhe” për Osmanin. Sipas tij, Kurti nuk dëshiron të negociojë për Osmanin, për të cilën besimi, pavarësisht se nga fundi i mandatit kanë pasur

bashkëpunim, nuk është sikurse më 2021. “E ka lënë me qëllim që të nënkuptohet që janë të mundshme të dyja variantet. LV-ja po luan me skenarin e presionit të madh, që të afrohet sa më shumë data e 4 marsit, dhe të ketë presion më të madh te opozita, që në rastin më të keq të pranohet cilido kandidat apo kandidatë që propozohet, vetëm të mos shkohet në zgjedhje të reja”, thotë Arifi për Radion Evropa e Lirë. As ish-partitë opozitare nuk duket se e kanë ndarë mendjen. Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë se fillimisht duhet të konstituohet Kuvendi dhe më pas të gjendet një formulë. Udhëheqësi i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka pohuar së voni se është i gatshëm të flasë me gjithë spektrin politik për t’i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje. Sipas tij, figura në pozitën e presidentit duhet të përfaqësojë “unitetin kombëtar” të Kosovës. “Na duhet komunikim publik brenda spektrit politik. Kjo është shumë e natyrshme. Kur flasim për marrëveshje politike, nuk e kemi fjalën për pazare politike, e kemi fjalën që duhet ulur partitë që t’i bëjnë numrat për një president të ardhshëm të Republikës së Kosovës”, ka thënë Abdixhiku. Partia e tij, LDK-ja, ka qenë ajo që ia ka bërë kuorumin Osmanit më 2021. Aleanca për Ardhmërinë e



Kosovës duket se do ta ketë kandidatin e vet. Pal Lekaj nga kjo parti tha ditë më parë se lideri i partisë, Ramush Haradinaj, mund të jetë kandidat. “Mendoj që është koha e duhur që opozita të unifikohet dhe të vendosë për një kandidat konsensual, e në këtë rast pse të mos ishte edhe zoti Haradinaj”, u shpreh Lekaj, duke shtuar se ka diskutime edhe me krerët e PDK-së dhe LDK-së në këtë drejtim. Arifi beson se këto parti nuk janë në pozitë shumë të favorshme, për shkak të rrezikut të zgjedhjeve të reja, andaj edhe mund të lëshojnë pe - nëse jo partia si një, mund të ketë deputetë që të paktën qëndrojnë në sallë. Sa iu përket minoriteteve joshumicë, tre përfaqësues të tyre - Emilija Rexhepi, Veton Berisha dhe Erxhan Galushi - thanë ditë më parë se do të votonin kandidatin që e propozon shumica, duke përmendur se kanë votë edhe për Osmanin.

Si zgjidhet presidenti i Kosovës?

Për ta çuar përpara një propozim duhet të sigurohen të paktën 30 nënshkrime të deputetëve. Një kandidat duhet t’i sigurojë dy të tretat e votave të deputetëve në Kuvendin me 120 karrige, ndërsa kuorumi arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t’i ketë 61.

Çfarë ndodh nëse nuk zgjidhet presidenti?

Këtë herë, përtej kalkulimeve partiake, mosrespektimi i afateve kohore do ta çonte shtetin në zgjedhje dhe do të rrezikonte ta paralizonte gjithë sistemin. Shteti do të mbetej pa buxhet dhe rrjedhimisht as nuk do të mund të ndaheshin fonde për proces tjetër zgjedhor. Mos të flasim për mungesë pagash për sektorin publik dhe një mori komplikimesh tjera.

Një tjetër fatkeqësi për shtetin do të ishte nëse nuk do të ratifikoheshin marrëveshjet ndërkombëtare për Planin e Rritjes të Bashkimit Evropian dhe ato me Bankën Botërore. Arifi beson se Kosova mund të përballët me zgjedhje të reja, vetëm nëse kalon në një “marrëzi totale kolektive politike”. “Përndryshe nëse ka pak racionalitet, partitë opozitare duhet ta marrin një vendim se si do të duket skena politike me presidenten, cilindo që do ta propozojë LV-ja. Normalisht, do të ishte mirë të kishin marrëveshje me LV-në, që të jetë një pushtet më balancues, por po vërehet që partia [LV-ja] nuk është e gatshme ta ndajë këtë pozitë”. Presidentja Osmani është kritikuar disa herë gjatë mandatit të saj se ka mbajtur anë nga Lëvizja Vetëvendosje. Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, në fund të dhjetorit, ajo tha se nëse nuk e fiton edhe një mandat, atëherë do t’i kthehet angazhimit politik, pa treguar se me cilën parti.

Kush është Michael Martens?

Martens është korrespondent i FAZ-it për Evropën Juglindore, me seli në Vjenë. Sipas biografisë së tij, të publikuar në FAZ, ai e nisi karrierën si redaktor për gazeta ruso-gjermane përmes një projekti të financuar nga Zyra e Jashtme gjermane. Më vonë ka raportuar për rajonet e Azisë Qendrore, Pakistanit, Afganistanit, Ukrainës dhe Rusisë. Ai punon për FAZ-in prej vitit 2001. Prej vitit 2002, për shtatë vjet rresht ka qenë korrespondent për Ballkanin, duke raportuar nga Beogradi.

A ka bazë për ndjekje ligjore?

Teksa nga Presidenca po paralajmërojnë ndjekje ligjore, këshilltarja ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, Flutura Kusari, ka argumentuar se një lëvizje e tillë do të dëmtonte vetë institucionin e presidentit dhe shtetin e Kosovës. Sipas saj, shkrimi në FAZ për Osmanin është analizë dhe trajton çështje me interes publik që “gëzojnë mbrojtje të lartë gjyqësore”. Kusari shkroi në Facebook se artikulli ofron opinione, vlerësime dhe analiza bazuar në njohuritë e autorit për

Kosovën dhe thirret në burime konfidenciale. “Opinionet nuk i nënshtrohen kriterit të verifikimit dhe, rrjedhimisht, gëzojnë mbrojtje të gjerë ligjore”, tha Kusari. Ajo tha se i vetmi fakt i ri i përmendur në shkrim është se “Rama ia ka siguruar Osmanit ulësen në Bordin e Paqes, fakt që nuk është kontestuar nga Osmani. Faktet i nënshtrohen verifikimit, prandaj nëse ky fakt nuk është i vërtetë, Osmani duhet ta ngre këtë si çështje”. “Për mua, shqetësues, por aspak befasues, është fakti që zyra e presidentes përmend ligjin penal si formë kërcënimi ndaj Martens ndonëse shpifja ndiqet sipas ligjet civil në

Gjermani dhe përmend fjalën dezinformatë për një shkrim të botuar nga gazeta prestigjioze FAZ. Kjo padi, nëse ushtrohet pranë gjykatave gjermane apo cilësdo gjykatë ku sundon ligji, nuk ka asnjë shans të fitohet”, argumentoi Kusari. Osmani ka thënë se është ftuar për të themeluar Bordin e Paqes me ftesë të presidentit Trump. Kosova e konsideron si qenësore aleancën me Shtetet e Bashkuara, vend që ka kontribuar në pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës. Osmani shpesh ka përmendur faktin se vendi i saj është më proamerikani në botë dhe ka lartësuar udhëheqjen e Trumpit.

Synimet e Osmanit për mandat të dytë

Presidentja e Kosovës e ka thënë hapur se synon edhe një mandat në krye të shtetit. Por, ajo është kritikuar disa herë gjatë mandatit të saj se ka mbajtur anë nga Lëvizja Vetëvendosje dhe ende nuk dihet nëse do t’i sigurojë votat e nevojshme për mandatin e ri. Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, në fund të dhjetorit, ajo tha se nëse nuk e fiton edhe një mandat, atëherë do t’i kthehet angazhimit politik, pa treguar se me cilën parti.

LV, SILLU E PËSHTILLU KAH DARDHA E AHMATIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Thembra e Akilit - formimi i institucioneve: KM kujdestar i Kosovës në pyetjet për formim të institucioneve u deklarua se zgjedhja e presidentit/es është hapi i katërt. Njëherë duhet të certifikohen rezultatet në zgjedhjet e vjedhura dhe të blera pas së cilës vijnë hapat e demonstrimit të ndershmërisë institucionale siç është formimi i Kuvendit, qeverisë dhe presidenti/ja si bira e fundit e kavallit! As në Bangladesh nuk janë vjedhur dhe blerë votat si në zgjedhjet e fundit lokale dhe të përgjithshme në Kosovë. Ndërkombëtarët e kanë të vetmin qëllim si ta bëjnë Zajebnicën dhe federalizimin e Kosovës që Albin Zeza e pranoi me Marrëveshjen e Brukselit dhe Aneksin e Ohrit me ndihmën e projugosllavit legjendar, Veton Surroit dhe mercenarit emblematic, Marc Weller, “dhëndrit të Kosovës”. Që të dy e materializuan mirë këtë poshtërsi ndërsa Kurthit i mbeti qepa e ngulur. Kjo është arsyeja kryesore pse Kurthi e

ka bllokuar jetën institucionale dhe politike në Kosovë duke e prurë vendin buzë vdekjes klinike. Për këtë arsye Kurthi aq ulët, përmes idiotëve funksionalë e sulmon Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Prokurorinë e Shtetit dhe Gjykatat nëse nuk ia “kruajnë bishtin”. Për këtë arsye i mbron me aq pasion hajnat milionësh të pushtetit duke i lënë të kullotin buxhetin e Kosovës më lirë se në “bahçe të babës”. Për këtë arsye ka qitë pushkë 55 herë për Lenka Haxhiun ndonëse e dinë shumë mirë kapacitetin e saj profesional. Për këtë arsye ka sistemuar për shtatë palë qejfe spiunët e UDB-së dhe i lufton pamëshirshëm dhe poshtërisht ish të burgosurit politik dhe UÇK-në! Për këtë arsye Nenad Rashiqit po i vendosë rreth kokës aureolën e Shqiptarit të Madh dhe Patriotit antikushtetues. Dhe shumë për të tjera.

Po si do të formohet Kuvendi? LV, pas zgjedhjeve të vjedhura

dhe të blera i ka 57 deputetë, kape njërën e mëshoji tjetrit në aspektin kombëtar dhe profesional. Gjykata Kushtetuese e bëri të qartë se nënkryetarin e Kuvendit nga radhët e serbëve e propozon subjekti që ka numrin më të madh të deputetëve, në rastin konkret Lista Serbe me 9 deputetë e jo Nenad Rashiqi me 1 deputet. Deputetët e Kuveleshit të LV-së në KQZ kundërshtuan certifikimin e LS-së, në emër të një patriotizmi folklorik kurse deputetët qyqarë të opozitës abstenuan ndonëse ligji dhe Kushtetuta ishin në anën e tyre. Oportunistë frikacakë, as mish e as peshk. Opozitë e tredhur! Opozitë fiktive! Opozitë e mjerë! Sa për opozitën, Kurthi me çetën e injorantëve dhe hajdutëve që e përcjellë si grigjë, do ta mbajë pushtetin si Titoja, Stalini dhe Enver Hoxha. Kombëtarisht, politikisht dhe ideologjikisht është pjellë e tyre. Nuk e kam të qartë si do të formohet Kuvendi i Kosovës pa u zgjedhur nënkryetari nga

Lista Serbe?! Nuk ka asnjë dallim nëse votohet individualisht apo në pako. Disi duhet të votojnë për ta formuar Kuvendin. Disa deputetë të LV-së, intelektual të jashtëzakonshëm në me krye Aristotel Agim Bahtirin, botërisht janë betuar se: “më parë do t’i presin duart se që do ta votojnë Listën Serbe.”. Nëse ky zotim publik do të jetësohet, shumë deputetë të LV-së do të mbesin pa duar, sikur hajnat në shtetet arabe që kapen duke vjedhur dhe dënohen sipas Ligjit të Sheriatit! A do të ndodhë kjo në Kosovë?! Nuk e besoj sepse këtu nuk zbatohen Ligjet e Sheriatit por “Rregullat e Kurthit” që nënkupton se mund të vjedhësh sa të duash, pa humbur asgjë! Lëre më duart! Me çka do të vjedhësh pastaj, nëse mbetesh pa duar?! Do ta kemi një situatë kur: “edhe ujku (Kurthi) do të jetë i ngopur, edhe delet (hajnat) e grigjës do të mbeten në numër”!

Nenad Rashiqin për president: Presidentja në theqafje, Vjosa Osmani i ka ndezur të gjithë motorët edhe për një mandat tjetër presidencial. Nuk po zgjedhë mjete për të arritur qëllimin. Po i llaskucavet Trampit, Melanisë, analistëve, gazetarëve, politikanëve, të rinjve dhe të moshuarve, tregut të brendshëm elektoral dhe diasporës, urbi et orbi ku sigurohen votat. Po fjalën e fundit e kanë deputetët, motorët i mbushë me vota ekskluzivisht Kurthi, ky autokrat pa dhëmbë dhe njeri pas asnjë ndjenjë apo empati. A ka interes Kurthi ta rizgjedhë përsëri pronaren e “shtëpive në varg” presidente? Në mandatin e parë Vojsa Osmani ishte rrogëtare e bindur e Kurthit, jo shkak i

respektit por shkak i nevojës për mandat të dytë. Për këto ditë. Hipotetikusht, nëse Osmani rizgjedhet presidente, Kurthi nuk ka asnjë mekanizëm apo mundësi detyrimi ta mbajë nën kontroll apo ta disiplinojë. Ky do të ishte mandati i fundit i Vjosa Osmanit dhe rrjedhimisht ajo nuk do të luftonte më për Kurthin por për karrierën e saj postpresidenciale. Edhe nëse 120 deputetë kërkojnë shkarkimin e presidentes/it, kjo nuk mund të bëhet. Në këtë lojë të fëlliqur kjo është përparësi e Vjosa Osmanit dhe hendikep i Albin Kurthit. Pastaj, për krijimin e Zajebnicës dhe zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit, Albin Kurthi i duhet një koçemadh, me pak tru, ku Kurthi do të mrizonte nën mrizin e tyre. Opozita nuk duhet ta votojë asnjë kandidat të propozuar nga Kurthi për president/e. Opozita duhet ta propozojë kandidatin, si një kompromis politik me Kurthin. Asgjë më pak se aq! Vjosa Osmani duhet të jetë kandidati i fundit që propozohet për president, nëse raca njerëzore rikthehet në kohën e Adamit (Albinit) dhe Vjosës (Evës). Vjosa Osmani është anëtare e “Bordit të Pagues”, një OQ (Organizatë Qeveritare) personale e presidentit Tramp. Çfarë emërtimi mizor dhe cinik, nënshkruese janë kryesisht shtetet që kanë probleme me paqen, republikat banana, shtetet autokrate dhe diktatoriale ku respektimi i të drejtave të njeriut është mision non grata, i padëshiruar dhe i pamundur. Imelda Markos e Kosovës është një diktatore e vogël, sipas kaçikut. Më shumë i duhet Trampit, se Kosovës!

FORMIMI I QEVERISË DHE PLANI I RRRITJES ME BE-në, NË FOKUS TË TAKIMIT BISLIMI - FRANGESH

PRISHTINË, 5 SHKURT - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, priti të enjten në takim përfaqësuesin e posaçëm të Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, Anzhej Frangesh. Sipas njoftimit të qeverisë, Frangesh në këtë takim ishte i shoqëruar nga ambasadori i Sllovenisë në Kosovë, Borut Blaj. “Së bashku diskutuan rreth zhvillimeve në vend dhe situatës në rajon”, thuhet në këtë njoftim. Zëvendëskryeministri Bislimi

theksoi rëndësinë e formimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 28 dhjetorit. Ai vuri në pah se “mbetet me rëndësi formimi sa më parë i qeverisë së re pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 28 dhjetorit, dhe votimi në Kuvend, mes të tjerash, edhe i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe Planit të Rritjes me Bashkimin Evropian”. Në përfundim të takimit, Bislimi falënderoi përfaqësuesin e posaçëm slloven për vizitën dhe bisedën, duke i uruar atij “qëndrim të frytshëm në Kosovë”.



‘RRITJA E ÇMIMIT TË RRYMËS NA VARFËRON’: RINIA E PDK-SË ME FATURË GJIGANTE, ALARMON PËR RITJEN 21 %

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 SHKURT - Rinia Demokratike e Kosovës të enjten përmes një aksioni simbolik para Ministrisë së Ekonomisë ka kundërshtuar paralajmërimet për rritjen e çmimit të energjisë elektrike mungesës së saj dhe faturave gjithnjë e më të papërbalueshme për qytetarët e Kosovës.

Gjatë aksionit të rinjtë e PDK-së lanë para kësaj ministrie edhe një faturë simbolike të përmasave të mëdha, e cila paraqet realitetin e hidhur të çmimeve të larta dhe jetesës me borxhe të familjeve të Kosovës.

Në emër të Rinisë Demokratike

të Kosovës para medieve foli kryetari i Degës së RDK-së në Prishtinë, Trim Syla, i cili theksoi se ky aksion është një thirrje për përgjegjësi dhe ndalje të goditjes së drejtpërdrejtë ndaj qytetarëve. “Sot s’kemi ardhur me pankarta. Kemi ardhur me një faturë. Një faturë që po e ngufatë jetën e qytetarëve çdo muaj. Një familje në Kosovë, me 1 000 euro të ardhura mujore, ka 1 085 euro shpenzime bazike. Pa luks. Pa pushime. Pa kurseime. Vetëm bukë. Vetëm rrymë. Vetëm ngrohje. Vetëm qira, ilaçe dhe shkollë për fëmijët. Minus 85 euro çdo muaj. Çdo muaj fillon me borxhe. Çdo muaj mbyllet me frikë”, tha Syla.

Syla tha se kjo faturë është



moster e një familje të vogël, ku dy prindërit janë të punësuar. “Paramendojeni sa e vështirë është jeta për ta e lëre më për një familje që ka vetëm një anëtar të punësuar. Aty nuk flasim më për vështirësi. Aty flasim për mbijetesë. Shkaku

kryesor? Rryma. 175 euro faturë mujore për energji elektrike. Rritja prej 21 % e çmimit të energjisë elektrike nuk është reformë. Është goditje direkte ndaj familjes. Është shtytje drejt varfërisë”, shtoi Syla.

Ai tha se qytetarët jo vetëm që po varfërohen, por edhe po vidhen. Sepse, sipas tij, kur rritet rryma, rritet buka, rritet transporti, rritet gjithçka, veç paga jo. “Energjia nuk është luks. Është nevojë bazike. Sot kjo faturë do të qëndrojë këtu derisa dikush të marrë përgjegjësinë, sepse Kosova nuk mund të qeveriset duke e ftohur shtëpinë e qytetarit për ta ngrohur propagandën e Albin Kurtit”, ka përfunduar Syla.

Rinia Demokratike e Kosovës kërkon ndaljen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, transparencë në menaxhimin e sektorit energjetik dhe politika që mbrojnë qytetarët, e jo që i shtynjë ata drejt varfërisë dhe borxheve.

“LIRIA KA EMËR” PRITET NË KLINË DHE FUSHË-KOSOVË, ELEZAJ DHE PREBREZA I JAPIN MBËSHTETJE MARSHIT “DREJTËSI, JO POLITIKË”

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 SHKURT - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, e kanë vizituar të enjten komunën e Klinës, ku janë pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Zenun Elezaj.

Hoxha dhe Tasholli e kanë njoftuar kryetarin Elezaj me misionin e platformës “Liria ka Emër” dhe me aktivitetet në kuadër të fushatës së mobilizimit qytetar për marshin “Drejtësi, jo politikë”, i cili do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare.

Ata shprehën mirënjohje për mbështetjen e dhënë nga kryetari i komunës dhe qyteti i Klinës. “Kur mbështetja për drejtësi vjen nga secila komunë, kjo kauzë merr edhe më shumë peshë. Më 17 shkurt marshojmë bashkë për drejtësi të vërtetë, jo të politizuar”, tha Hoxha. “E falënderojmë kryetarin për pritjen që na e bëri dhe



gatishmërinë e tij për ta mbështetur pa rezervë marshin”, tha Tasholli.

Kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj, duke theksuar se drejtësia duhet të jetë e paanshme dhe larg çdo ndikimi politik, u zotua për mobilizim gjithëkomunal për këtë marsh.

“Marshi “Drejtësi, jo politikë” është një thirrje e drejtë qytetare dhe i ftoj qytetarët e Klinës, por edhe të gjithë Kosovën, që më 17 shkurt të jenë pjesë e këtij marshimi paqësor për drejtësi të vërtetë”, ka theksuar ai.

Edhe kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, i



ka dhënë mbështetje marshit “Drejtësi, jo politikë!”. “Mbështetja juaj është dëshmi e përgjegjësisë institucionale dhe e qëndrimit në anën e drejtësisë dhe vlerave që bashkojnë qytetarët. Më 17 shkurt, bashkë, marshojmë për drejtësi”, kanë thënë përfaqësuesit e platformës

“Liria ka Emër”.

Platforma “Liria ka Emër” do t’i vazhdojë takimet dhe aktivitetet në tërë komunat e Kosovës dhe me të gjithë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë për mobilizim sa më të gjerë qytetar për marshin e 17 shkurtit, me moton “Drejtësi, jo politikë”.

EULEX-i dhe KFOR-i rrisin gatishmërinë për reagim në raste emergjente

PRISHTINË, 5 SHKURT - Pjesëtarë të Njësisë së Ndërhyrjes së Policisë së Specializuar (NJPS) të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), së bashku me njësi të misionit KFOR të udhëhequr nga NATO, kanë zhvilluar ushtrime të

përbashkëta trajnimi për evakuim mjekësor ajror (Air MEDEVAC). Ushtrimet janë mbajtur më 4 shkurt në Kampin Bondsteel dhe kanë përfshirë trajnime teorike dhe praktike, me qëllim të fuqizimit të bashkërendimit ndërmjet njësive dhe avancimit

të gatishmërisë operacionale për reagim në raste emergjente. Sipas njoftimit të EULEX-it, aktiviteti kishte për synim përgatitjen e pjesëtarëve për situata reale, duke rritur aftësitë për menaxhimin e emergjencave dhe ndërhyrjen e shpejtë përmes evakuimit

mjekësor ajror.

EULEX-i thekson se ushtrime të tilla të përbashkëta kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në garantimin e një reagimi efikas dhe të koordinuar në raste të emergjencave në terren.



AUDITORJA E PËRGJITHSHME MERR PJESË NË SAMITIN GLOBAL PËR AUDITIM DHE AI

PRISHTINË, 5 SHKURT - Autoriteti i Llogaridhënies i Emirateve të Bashkuara Arabe, më 2 dhe 3 shkurt 2026 në Abu Dhabi organizoi konferencën ndërkombëtare “Ripërcaktimi i auditimit në epokën e Inteligjencës Artificiale (AI)”, ku morën pjesë auditorja e përgjithshme, Vlorë Spanca, dhe zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj, me staf mbështetës. Konferenca bëri bashkë drejtues dhe përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit nga vende të ndryshme të botës dhe u fokusua në ndikimin e inteligjencës artificiale në auditimin publik si dhe në mënyrat se si teknologjia mund ta rrisë efikasitetin, transparencën dhe saktësinë e procesit të auditimit. Punimet e konferencës u hapën me fjalë hyrëse nga auditori i përgjithshëm i Emirateve të Bashkuara Arabe, Humaid Obaid Khalifa Obaid Abushibs, auditori

i përgjithshëm i Izraelit, njëherësh president i EUROSAT-t, Matanyahu Englman, si dhe shkencëtari kryesor dr. Sterling Thomas nga Zyra Qeveritare për Llogaridhënie në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pjesëmarrësit përgjatë dy ditëve ndanë përvojat dhe praktikatat më të fundit të përdorimit të AI në auditime përmes prezantimeve interaktive dhe shembujve praktikë nga ekspertë të institucioneve supreme të auditimit nga më shumë se 20 vende të botës. Në kuadër të sesioneve punuese u testuan mjete të AI për auditime më të shpejta dhe më të sakta. Diskutimet u fokusuan gjithashtu në sfidat dhe mundësitë e ardhshme të AI në sektorin publik, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për auditim publik më efektiv dhe për qeverisje më të mirë. Në kuadër të konferencës, auditorja e përgjithshme Vlorë



Spanca ka zhvilluar takime të veçanta me homologë nga vende të ndryshme duke përfshirë auditorin e përgjithshëm të Zvicrës, Maltës, Estonisë, Sllovakisë, Maqedonisë së Veriut si dhe përfaqësues të tjerë. Gjithashtu gjatë qëndrimit në Emiratet e Bashkuara Arabe, auditorja e përgjithshme Vlorë Spanca mori pjesë në sesionin e

parë të punimeve të Samitit Botëror të Qeverisjes, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë institucionale, liderëve qeveritarë, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertëve nga mbarë bota. Gjatë samitit u zhvilluan panele diskutimi dhe sesione të ndryshme, të cilat trajtuan tema me rëndësi të veçantë, përfshirë

qeverisjen e mirë, inovacionin digjital dhe sfidat e së ardhmes. Pjesëmarrja e auditorës së përgjithshme në këtë samit përbën një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave profesionale, ndërtimin e partneriteteve institucionale, si dhe forcimin e rolit të institucioneve supreme të auditimit në nivel botëror.

GUVERNATORI ISMAILI PRET MISIONIN E FMN-SË PËR KONSULTIMET E NENIT IV TË MARRËVESHJES ME FMN-NË

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 5 shkurt - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorët Cakaj dhe Fusha dhe stafin e BQK-së, prit Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë për zhvillimin e konsultimeve të rregullta sipas Nenit IV. Misioni udhëhiqet nga David Amaglobeli, shef i Misionit të FMN-së për Kosovën dhe përfshin Sebastian Sosa, përfaqësues rajonal i FMN-së për Ballkanin Perëndimor me seli në Vjenë, së bashku me stafin e FMN-së nga Uashingtoni. Në takimin hapës guvernatori Ismaili shprehu vlerësimin e tij për bashkëpunimin e vazhdueshëm me FMN-në si dhe për asistencën profesionale



dhe teknike të ofruar ndër vite. Ai paraqiti zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë dhe theksoi stabilitetin e përgjithshëm të sektorit financiar. Po ashtu, guvernatori Ismaili informoi misionin e FMN-së për reformat në vazhdim në sektorin financiar, përfshirë avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse në fushën e stabilitetit financiar dhe modelimit makroekonomik,

mbikëqyrjes financiare, mbikëqyrjes së praktikave të tregut, sigurisë kibernetike dhe inteligjencës artificiale. Këto reforma mbështeten nga asistencat teknike e FMN-së, si dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare dhe banka qendrore partnere. Guvernatori Ismaili gjithashtu theksoi zhvillimet në sektorin bankar, duke nënvizuar nivelet e larta të kapitalizimit dhe

likuiditetit, si dhe zhvillimet pozitive në sektorë të tjerë financiarë, të cilat në tërësi konfirmojnë stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë. Nga ana e tij, Amaglobeli vlerësoi bashkëpunimin konstruktiv ndërmjet BQK-së dhe FMN-së dhe përgëzoi BQK-në për përpunimin e arritur në forcimin e kornizave institucionale dhe rregullative si dhe për bashkëpunimin në fusha të ndryshme përmes asistencave teknike. Gjatë takimit diskutimet u fokusuan në zbatimin e rekomandimeve nga konsultimet e mëparshme të Nenit IV. Po ashtu, u diskutuan edhe mundësitë për aranzhime të reja me FMN-në, me theks të veçantë në forcimin dhe reformimin e mëtejshëm të sistemit financiar. Në përmbllje të takimit,

guvernatori Ismaili vlerësoi lart mbështetjen profesionale dhe teknike afatgjatë të FMN-së për BQK-në, si në avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, ashtu edhe në forcimin e kapaciteteve institucionale. Ai riafirmoi përkushtimin e BQK-së për vazhdimin e bashkëpunimit me FMN-në përmes projekteve dhe programeve që synojnë avancimin e reformave institucionale dhe arrijtjen e objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të BQK-së. Misioni i FMN-së do të qëndrojë në Kosovë nga 3 deri më 13 shkurt, gjatë së cilës periudhë do të zhvillojë diskutime tematike me stafin e BQK-së si dhe me institucione të tjera të Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 4 të Marrëveshjes së FMN-së me vendet anëtare.

Kurti dhe Rizvanolli përrurojnë investimet në efijencë të energjisë në dy shkolla të Podujevës

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, si dhe u. d. drejtoresha e Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), Ardiana Bokshi, morën pjesë në ceremoninë e përrurimit të investimeve në efijencë të energjisë në Shkollën e Mesme Ekonomike “Isa Boletini” dhe në shkollën “Shefki Kuleta” në

fshatin Tërnavë të Podujevës. Investimi është realizuar gjithsej në 8 shkolla në komunën e Podujevës, në të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës ka investuar 750 mijë euro, ndërsa me mbështetja e Bashkimit Evropian, arrin vlerën 1.5 milionë euro. Në kuadër të këtyre investimeve është bërë ndërrimi i detyrës dhe dritareve, izolimi i kulmit dhe mureve, si dhe optimizimi i sistemit të ngrohjes me kapacitet prej 300 KW.

Me këtë rast kryeministri Kurti theksoi se falë këtyre investimeve, në Shkollën e Mesme Ekonomike “Isa Boletini”, investimi në efijencë të energjisë elektrike është 350 mijë euro ku kushte më të mira do të kenë mbi 1 000 nxënës dhe rreth 100 mësime. Ndërkaq 135 nxënës në Tërnavë të Podujevës, në shkollën “Shefki Kuleta”, do t'i gëzojnë të njëjtat investime në efijencë të energjisë.



A ËSHTË VULLNETI I LIRË NJË ILUZION?

Nëse njeriu ka apo jo vullnet të lirë është një pyetje që filozofët e kanë debatuar prej mijëra vitesh. Në fillim të viteve '80, për një moment të shkurtër, u duk sikur ky debat më në fund ishte zgjidhur. Por zgjidhja nuk erdhi nga filozofia, ajo erdhi nga neuroshkenca.

Përgjigjja ishte disi dëshpëruese: vullneti i lirë nuk ekziston. Eksperimentet e kryera nga neuroshkencëtari Benjamin Libet dukeshin se tregonin se vendimet merren në tru përpara se njerëzit të jenë të vetëdijshëm për to. Sikur shkenca të kishte zbuluar më në fund fijet e padukshme që kontrollojnë mendimet dhe veprimet tona. Për këdo që ka ndjekur qoftë edhe në mënyrë sipërfaqësore historinë e debatit mbi vullnetin e lirë, ky përfundim u duk i nxituar. Dhe fatmirësisht, ky dyshim doli i drejtë.

Sot, shkencëtarët janë shumë më skeptikë, jo vetëm ndaj idesë se vullneti i lirë nuk ekziston, por edhe ndaj nocionit se skanimet e trurit do të jenë ndonjëherë në gjendje ta provojnë apo ta rrëzojnë përfundimisht ekzistencën e tij. Po pse?

Si e marrim një vendim?

Në fund të fundit, çështja e vullnetit të lirë mund t'u lihet filozofëve, por kjo nuk do të thotë se neuroshkencëtarët duhet ta injorojnë atë. Eksperimentet mbi mënyrën se si truri i njeriut merr vendime kanë sjellë njohuri të rëndësishme për neurologjinë dhe psikologjinë, duke zgjeruar kuptimin tonë mbi funksionimin e brendshëm të trurit.

Këtu përfshihen edhe eksperimentet e Libet-it në vitet '80, të cilat, edhe pse sot shihen me më shumë kritikë, hapën rrugën për dekada kërkimesh novatore.

Eksperimentet ishin relativisht të thjeshta. Libet i lidhte vullnetarët me një elektroencefalograf (EEG) për të monitoruar aktivitetin e trurit, më pas u vendoste përpara një buton dhe u kërkonte të vendosnin vetë se kur do ta shtypnin. Gjatë vendimmarrjes, ata duhej të shikonin një kohëmatës, një pikë që lëvizte rrotull një rrethi, si akrepi i sekondave në orë. Çdo pjesëmarrës duhej të shënonte pozicionin e pikës në momentin kur vendoste të shtypte butonin. Përmes EEG-së, Libet kërkonte atë që quhet “potencial

gatishmërie”, një rritje e aktivitetit në korteksin motorik të trurit që paraprin një lëvizje muskulore.

Ai donte të shihte se si përputhej ndërgjegjësimi i vullnetarit për vendimin e tij me këtë sinjal neurologjik.

Rezultati ishte befasues: modeli karakteristik i potencialit të gatishmërisë shfaqej rreth 200 milisekonda përpara se pjesëmarrësit të raportonin se kishin marrë vendimin për të shtypur butonin. Me fjalë të tjera, truri po përgatitej të vepronte përpara se personi të ishte i vetëdijshëm për vendimin.

Interpretimi ishte i qartë: proceset e pavetëdijshme paraprijnë dhe përcaktojnë veprimet tona të qëllimshme. “Në parim, kjo është marrë si provë se ne nuk kemi vullnet të lirë, ose të paktën jo vullnet të lirë të vetëdijshëm,” shpjegon profesori Marcel Brass, neuroshkencëtar konjitiv në Universitetin Humboldt të Berlinit. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, do të ishte një përfundim thellësisht tronditës.

Pse përfundimi i Libet-it nuk qëndron më?

Siç vëren Brass, studiuesit e mëvonshëm kanë kritikuar si metodologjinë, ashtu edhe përfundimet e Libet-it. Për shembull, eksperimenti mbështetej në vlerësimin subjektiv të pjesëmarrësve për momentin kur ata mendonin se kishin marrë një vendim, një matje larg të qenit e saktë. Për më tepër, eksperimenti analizonte vendime shumë të thjeshta, pothuaj instiktive. A do të vlejë në njëjtat përfundime për vendime komplekse, si zgjedhja e një pune të re apo vendimi për t'u martuar?

Disa shkencëtarë kanë argumentuar se, edhe pse Libet identifikoi një sinjal përgatitor në tru, kjo nuk do të thotë se veprimi është i pashmangshëm. Përgatitjet mund të anulohen. Eksperimentet e mëvonshme sugjeruan se njerëzit mund t'i ndalnin veprimet e paralajmëruara nga potenciali i gatishmërisë, megjithëse studime të tjera kanë vënë në dyshim nëse ekziston vërtet koha e nevojshme për ta bërë këtë.

Sipas Brass-it, ajo që pa Libet nuk ishte truri duke nisur një veprim, por truri duke formuluar



një vendim. “Njerëzit grumbullojnë prova për një zgjedhje të caktuar dhe, kur kjo arrin një prag të caktuar, vendimi merret,” thotë ai. “Kjo do të thotë se aktiviteti i trurit pasqyron procesin e vendimmarrjes, por nuk është determinist.”

Studime më të fundit, që analizojnë të ashtuquajturat “potenciale të gatishmërisë të lateralizuara”, duke krahasuar të dy hemisferat e trurit, e mbështesin këtë ide. Kur pjesëmarrësit duhet të bëjnë një zgjedhje të thjeshtë “po” ose “jo”, aktiviteti neurologjik parashikon të dyja opsionet, duke u ndërtuar paralelisht në anë të ndryshme të trurit. Vetëm kur aktiviteti në njërin anë kalon një prag të caktuar, truri bën zgjedhjen. Eksperimente të tilla e kanë bindur Brass-in se neuroshkenca ende nuk e ka rrëzuar konceptin e vullnetit të lirë.

Madje, sipas tij, kjo është edhe çështje e logjikës së thjeshtë. “Nëse në trurin tonë do të ekzistonte një proces që përcakton në mënyrë të ngurtë se çfarë do të bëjmë, ne do të ishim jashtëzakonisht të pandryshueshëm,” thotë ai. “Në parim, ne duhet të jemi në gjendje të rishikojmë ose të ndryshojmë drejtimin e veprimeve tona brenda një kohe relativisht të shkurtër.”

Një kundërgargument

Jo të gjithë bien dakord se vullneti i lirë ekziston.

Profesori Robert Sapolsky, primatolog dhe neuroshkencëtar në Universitetin e Stanfordit në SHBA, argumenton se përvoja jonë e vetëdijshme e vullnetit të lirë është thjesht një iluzion i krijuar nga mendja jonë. “Në thelb, gjithçka që jemi është biologji, mbi të cilën nuk kemi asnjë kontroll, që ndërvepron me mjedisin, mbi të cilin po ashtu nuk kemi kontroll. Nuk ka asgjë tjetër përtej kësaj,” thotë ai. Argumenti i tij mbështetet në determinizmin e fizikës, ku veprimet ndjekin ligje të qarta dhe të pandryshueshme: molekulat nuk vendosin nëse do të reagojnë apo jo; objektet nuk vendosin nëse do t'i binden ligjit të gravitetit. Nëse biologjia jonë reduktohet në kimi dhe fizikë, atëherë edhe ne mund të jemi të lidhur pas ligjeve që i qeverisin ato.

Edhe vendimet më komplekse burojnë nga i njëjti qark nervor, argumenton Sapolsky. Vendimi për t'u shpërngulur në Londër vitin e ardhshëm apo për të filluar të luash pickleball, vjen nga e njëjta strukturë deterministe e trurit që përcakton reagimin për të

tërhequr dorën nga një sobë e nxehtë.

Megjithatë, disa shkencëtarë të tjerë mendojnë se kërkimi i (mos-)ekzistencës së vullnetit të lirë vetëm në biologji mund të jetë i pamjaftueshëm. Edhe pse mbetet një teori e debatueshme, disa besojnë se vullneti i lirë mund të lindë në një shkallë shumë më të vogël: në botën kuantike.

Sipas teorisë kuantike, grimcat mund të ekzistojnë njëkohësisht në dy gjendje (superpozicion), të cilat më pas “rrëzohen” në njërin ose tjetrën, shpesh sapo dikush përpiket t'i masë. Ky proces konsiderohet zakonisht i rastësishëm, pra i papërcaktuar paraprakisht.

Disa studiues po eksplorojnë mënyrat se si ndërveprimet kuantike mund të veprojnë në trurin tonë, duke patur ndikim mbi funksionimin e neuroneve. Edhe pse larg sigurisë shkencore, ekziston mundësia që luhatjet kuantike të rastësishme të luajnë një rol në formësimin e vendimeve tona, duke futur një element jodeterminist, dhe ndoshta, një formë vullneti të lirë, në veprimet tona.

Biokimisti Danko Georgiev nga Universiteti Mjekësor i Varnës në Bullgari ka shkruar edhe më tej, duke llogaritur sasinë e vullnetit të lirë që, sipas tij, buron nga këto

luhatje kuantike në sinapset kortikale të trurit: 0.934 bit vullneti i lirë për çdo sinaps, sa herë që një neuron aktivizohet. Sapolsky nuk bindet nga argumenti kuantik. Sipas tij, këto fenomene janë relevante vetëm në shkallë shumë të vogla për të ndikuar biologjinë. Për më tepër, ai thotë se është gabim të ngatërrohet rastësia me vullnetin e lirë. Nëse vendimet tona varen nga luhatjet e rastësishme të atomeve, atëherë ato nuk do të ishin vendime tona, por thjesht zhurmë statistikore. Megjithatë, Sapolsky nuk beson as në një Univers plotësisht të paracaktuar. Edhe nëse pranojmë se vendimet tona mund të reduktohen në ligjet deterministe të fizikës, kjo nuk do të thotë se e ardhmja është plotësisht e njohur. Ngjarje të rastësishme ndodhin vazhdimisht; ajo që është e paracaktuar, sipas tij, është mënyra se si truri ynë reagon ndaj tyre.

Duhet t'ua lëmë filozofëve

Ndërsa studimi biologjik i vendimmarrjes ka përparuar, shumë shkencëtarë kanë filluar


të pyesin nëse neuroshkenca është vërtet mjeti i duhur për t'iu përgjigjur pyetjes së vullnetit të lirë. Edhe pse kërkimet kanë bërë përparime të mëdha në analizimin e qëllimeve, vendimeve dhe nismave të veprimit në nivel neurologjik, ato nuk kanë ndikuar drejtpërdrejt në vetë konceptin e lirisë, argumenton neuroshkencëtarja dhe filozofja Adina Roskies nga Universiteti i Kalifornisë, Santa Barbara. “Asnjë prej këtyre studimeve nuk po investigon drejtpërdrejt çështjen e lirisë, e cila, sipas mendimit tim, duhet të adresohet fillimisht në mënyrë filozofike, përpara se të kuptojmë se çfarë do të thotë liri,” thotë ajo. Në fund të fundit, si do të dukej ‘liria’ në tru? Sipas Roskies, shkencëtarët mund të mos bien asnjëherë dakord, sepse përkufizimet përfundimtare të lirisë janë të paqarta dhe ndryshojnë nga një individ tek tjetri. Ajo propozon një përkufizim filozofik rigoroz: “A ndodhin veprimet tona në mënyrë të tillë që ne mendojmë se jemi autorë të tyre, apo në mënyrë të tillë që jemi të kontrolluar, të kufizuar ose të përcaktuar në mënyra që e bëjnë të pamundur t'i konsiderojmë

ato si të lira?” Është një përkufizim që mund t'i shkaktojë dhimbje koke kujt do, por që nxjerr në pah thellësinë filozofike të pyetjes. Ky hendek mes perceptimit popullor të vullnetit të lirë dhe realitetit të tij kompleks ka turbulluar debatin për dekada, thotë Roskies. “Shpesh mendoj se kur neuroshkencëtarët bëjnë deklarata të mëdha mbi ndikimin e të dhënave të tyre në problemin e vullnetit të lirë, ata e bëjnë këtë pa e kuptuar vërtet terrenin filozofik,” shton ajo. Sot, shumica e neuroshkencëtarëve e kufizojnë më ngushtë fushën e tyre, duke u fokusuar te vullneti për veprim dhe vendimmarrja, elemente të rëndësishme për të kuptuar vullnetin e lirë, por që kanë një bazë konkrete në realitet. Sipas Roskies, shkenca sugjeron ekzistencën e një spektri të vullnetit të lirë, i cili ndryshon nga personi në person dhe nga konteksti në kontekst. “Vullneti i lirë, sipas mendimit tim, varet nga një bashkësi aftësish për të vepruar. Disa individë ose situata kanë më shumë nga këto aftësi, të tjerë më pak,” thotë ajo. Disa eksperimente përputhen me këtë qasje. Një studim i vitit 2019 nga studiues në SHBA dhe

Izrael analizoi vendime më komplekse. Pjesëmarrësit duhej të merrnin dy vendime mbi donacione për organizata jofitimprurëse. Në rastin e parë, ata zgjidhnin se cilës organizatë t'i dhuronin 1,000 dollarë. Në rastin e dytë, u thuhej se secila organizatë do të merrte nga 500 dollarë, pavarësisht se cilin buton shtypnin. Studiuesit gjetën potencial gatishmërie vetëm në rastin e dytë, ku realisht nuk kishte asnjë vendim për t'u marrë. Në rastin e parë, ku kërkohet një zgjedhje reale, ky sinjal mungonte. Autorët e studimit e konsiderojnë këtë si kundërshtim të idesë se potenciali i gatishmërisë qëndron në themel të të gjitha veprimeve tona, dhe si provë se gjendja njohëse ndikon në mënyrën se si zhvillohen vendimet në tru. Për vendime që përfshijnë konsiderata më të thella, si në çështje morale apo vlerësimi, proceset tona të menduarit, dhe ndoshta edhe liria jonë për të zgjedhur, mund të duken ndryshe. Në një variant tjetër të këtyre eksperimenteve me butona, Brass dhe kolegët e tij arritën të parashikonin se cilin buton do të shtypte një pjesëmarrës deri në dhjetë sekonda përpara se

vendimi të merrej. Por, siç thekson Brass, këto parashikime nuk ishin aspakt perfekte, vetëm pak më të mira se hamendësimet e rastësishme. “Nuk mund të parashikosh në mënyrë deterministe se çfarë do të bëjnë njerëzit, përveçse shumë afër momentit të vendimit,” thotë ai. Edhe pse shkenca nuk ka arritur ende një përgjigje përfundimtare mbi ekzistencën e vullnetit të lirë, këto eksperimente mbeten me vlerë. Ato jo vetëm që zbulojnë mënyrën se si truri funksionon gjatë procesit të vendimmarrjes, por kanë edhe pasoja të rëndësishme për sistemin e drejtësisë, ku juritë duhet të vlerësojnë shkallën e fajësisë së një të pandehuri. Të kuptuarit e aftësive që nevojiten për të vepruar lirisht, dhe mënyrat se si këto aftësi mund të dëmtohen nga sëmundjet apo dëmtimet, mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si mendojmë për krimin dhe ndëshkimin, thotë Roskies. Nëse neuroshkenca nuk mund të thotë përfundimisht se nuk jemi të lirë, ndoshta pyetja e vërtetë është: sa të lirë mund të mendojmë realisht se jemi? / *Science Focus – Bota.al*





ADEMI RIZGJEDHET PRESIDENT I FFK-së: VOTA JUAJ, VLERËSIM I PUNËS SË BËRË BASHKËRISHT

Agim Ademi është rizgjedhur president i Federatës së Futbollit të Kosovës edhe për një mandat katërvjeçar. Pasi ka marrë mbështetje unanime për ta drejtuar FFK-në, Ademi i ka falënderuar delegatët për besimin dhe ka theksuar rëndësinë e unitetit e bashkëpunimit në udhëheqjen e futbollit të Kosovës

Prishtinë, 5 shkurt - Agim Ademi është rizgjedhur president i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për mandatin e ri 2026-2030. Në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor të FFK-së Ademi ka marrë mbështetjen unanime të delegatëve, pasi nga 52 delegatë të pranishëm në punimet e Kuvendit, të gjithë kanë votuar për rizgjedhjen e tij. Paraprakisht presidenti Ademi ka paraqitur Raportin e Punës për vitin 2025 si dhe programin voluminoz për mandatin e ri me moton "Me futbollin, për Kosovën". Po ashtu, me 49 vota për dhe tri abstenime janë zgjedhur edhe anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së. Pas rizgjedhjes, presidenti Ademi ka falënderuar delegatët për besimin dhe ka theksuar rëndësinë e unitetit dhe bashkëpunimit në udhëheqjen e futbollit të Kosovës. "Vota juaj sot është besim për mua dhe për ekipin tim. Vota juaj është vlerësim i punës së bërë bashkërisht dhe përkrahje për të ardhmen dhe punën e ardhshme. Pozita e presidentit të Federatës është përgjegjësi dhe detyrë të cilën do ta ushtroj me

përkushtim maksimal. Do të jem gjithmonë në shërbimin tuaj dhe në shërbim të futbollit. Këtë punë nuk e kam bërë i vetëm, por së bashku me stafin tim dhe administratën e FFK-së të cilët i falënderoj për angazhimin e tyre të vazhdueshëm. FFK është një organizatë joqeveritare, por me rol të veçantë për faktin se përfaqëson shtetin në arenën ndërkombëtare. Kjo na obligon të jemi më transparentë, më të përgjegjshëm dhe më të përkushtuar. Jam i lumtur që ky Kuvend është i unifikuar dhe që vendimet i marrim bashkë për të mirën e futbollit. Uniteti dhe vota juaj nuk janë ngufatje e demokracisë, por shprehje e vlerësimit dhe besimit ndaj meje dhe institucionit të futbollit. Na priftë e mbara dhe shpresoj që futbollin e Kosovës ta shohim gjithnjë e më larg", ka thënë presidenti Ademi. Punimet e Kuvendit janë monitoruar nga afër nga zëvendës-presidenti i UEFA-s, Armand Duka, Rolf Tanner, drejtor i qeverisjes në FIFA, Marco Ferri, përfaqësues i FIFA-s, Enis Bastari, drejtor i zhvillimit të federatave në UEFA si dhe nga



përfaqësuesit institucionalë Fidan Shatri dhe Mehdi Uka nga MKRS-ja dhe Gazmend Maxhuni nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Kuvendi është përshëndetur fillimisht nga zëvendës-presidenti i UEFA-s, Armand Duka, i cili ka përcjell përshëndetjet e presidentit të UEFA-s, Aleksander Ceferin, dhe sekretarit të përgjithshëm të UEFA-s, Theodore Theodoridis. Ai ka vlerësuar edhe sukseset sportive të kombëtares A dhe klubeve të Kosovës në garat evropiane. Ndërkohë, drejtori i qeverisjes në FIFA, Rolf Tanner, ka theksuar përparimin e jashtëzakonshëm të futbollit të Kosovës që nga pranimi në FIFA dhe UEFA. Ndërsa në emër të MKRS-së, Fidan Shatri ka konfirmuar respektimin e autonomisë së FFK-së dhe ka theksuar se roli i

ministrisë është rregullativ, në përputhje me ligjin. Në anën tjetër, përfaqësuesi i Komitetit Olimpik të Kosovës, Gazmend Maxhuni, ka vlerësuar stabilitetin dhe sukseset e FFK-së, duke uruar realizim të projekteve të reja në mandatin e ardhshëm. Gjatë punimeve të

Kuvendit, delegatët kanë miratuar Raportin e Punës, Raportin e Auditorit, buxhetin për vitin 2026, si dhe auditorin e jashtëm për vitin 2026.

Paraqitet fanella e re, "Dardanët" do të vishen nga "Adidas"-i

Federata e Futbollit të Kosovës nga ky vit do të vishet me fanellat e markës së njohur gjermane "Adidas". Këtë e ka konfirmuar presidenti i FFK-së, Agim Ademi, në Kuvendin Zgjedhor. Ademi ka paraqitur fanellën e "Dardanëve", teksa ka thënë se të gjitha ekipet nacionale do të vishen me "Adidas". "Ekipet tona nacionale nga ky vit do të vishen nga 'Adidas'. Kjo është fanella e Kosovës dhe shpresoj që do të prezantohemi me të në ShBA", ka thënë Ademi.



VEDAT MURIQI NË TOP 5-she PËR "KËPUCËN E ARTË"

MALLORCA, 5 SHKURT - Gara për çmimin prestigjioz "Këpuca e Artë" evropiane po bëhet gjithnjë e më e fortë, me dy nga sulmuesit më të mirë në botë, Harry Kane dhe Kylian Mbappe, që vazhdojnë të ndajnë vendin e parë në renditje. Sulmuesi anglez i Bayern Munichut dhe ylli francez i Real Madridit kanë grumbulluar nga 44 pikë secili falë 22 golave të realizuar në kampionatet respektive. Pas tyre renditet sulmuesi norvegjez i Manchester Cityt,

Erling Haaland, i cili aktualisht ka 40 pikë dhe mbetet një pretendent serioz në garën për podiumin. Ndërkohë, vëmendje të veçantë po tërheq edhe sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, i cili po kalon një sezon shumë të mirë me Mallorcan dhe renditet në mesin e pesë golashënuesve më të mirë në Evropë, me 30 pikë. Në listën e përditësuar paraqitje të mirë po vazhdon të ketë edhe kapiteni i Interit, Lautaro Martinez. Sulmuesi



TOP 5-shja AKTUALE E RENDITJES PËR "KËPUCËN E ARTË" EVROPIANE:

Harry Kane (Bayern Munich) - 44 pikë
Kylian Mbappe (Real Madrid) - 44 pikë
Erling Haaland (Manchester City) - 40 pikë
Igor Thiago (Brentford) - 32 pikë
Vedat Muriqi (Mallorca) - 30 pikë

argentinës ka arritur në kuotën e 13 golave dhe 26 pikëve, duke u renditur aktualisht në pozitën e 13-të dhe duke mbajtur ende gjallë shpresat për t'u afruar me

kreun e renditjes. Çmimi "Këpuca e Artë" jepet mbi bazën e numrit të golave të shënuar gjatë sezonit, të shumëzuar me koeficientin e kampionatit përkatës sipas renditjes së UEFA-s. Golat e realizuar në pesë ligat më të forta evropiane - Angli, Itali, Spanjë, Gjermani dhe Francë - vlejnjë nga 2 pikë, ndërsa golat në kampionatet e renditura nga vendi i gjashtë deri në të njëzetedytin vlejnjë 1.5 pikë. Në ligat e tjera, çdo gol vlerësohet me 1 pikë.

Trabzonspori insiston për Milot Rashicën

TRABZON, 5 SHKURT - Pas Ernest Muçit, skuadra e Trabzonsporit po synon edhe transferimin e Milot Rashicës nga Beshiktashi, kanë njoftuar mediet në Turqi. Trabzonspori po insiston për Rashicën, të cilin po shpreson ta sigurojë deri të premten, ditën e

fundit të afatit kalimtar të dimrit në Turqi. Rashica te Trabzonspori po shihet si përforsim i rëndësishëm për sulmin dhe kjo është arsyeja që po insistojnë ta bindin Beshiktashin, ekip prej të cilit në verë e huazuan Muçin.

Trabzonspori i ka ofruar tri opsione Beshiktashit për shërbimet e Rashicës, huazimin e tij, blerjen me këste dhe shkëmbimin me ndonjë lojtar tjetër. Mbetet të shihet nëse marrëveshja mes klubeve do të arrihet deri sot (e premte),

ndonëse Rashica gjatë dimrit është kërkuar edhe nga Hoffenheimi i Gjermanisë. Rashica ka kontratë me Beshiktashin deri në vitin e ardhshëm, ndërsa këtë sezon ka 2 gola e 3 asistime në 22 paraqitje.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 120/1
Datë: 05.02.2026

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 26.01.2026 me nr. 151/26 të **QK “11 Marsi” – Prizren** shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të QK “11 Marsi” – Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensinet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të ketë licencën e punës.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit në Durrës me data të caktuara sipas vendimit nga KDSH-ja (**prej 22.04. deri 26.04.2026**).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do të bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2023-2024-2025)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt 22.04.2026 dhe kthimi më dt 26.04.2026
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Berat, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 13:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndertesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus dy ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Princi Company” Sh.p.k. Harilaq, Fushë Kosovë, kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/5240/MMPHI/398/DMM për veprimtarinë: Fabrikë e Seleksionimit dhe Ambalazhimit të Plastikës, Letrës, Qelqit, Metaleve si dhe Djegien e Mbeturinave Medicinale – Barnave me Afat të Skaduar (shtim i kodeve), organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 27.02.2026, në ora: 09:30, në hapësirat e Administrative te Kompanise “Princi Company” Sh.p.k. Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës, do të organizohet debat publik nga operatori “Princi Company” Sh.p.k. Harilaq, Fushë Kosovë, kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/5240/MMPHI/398/DMM për veprimtarinë: Fabrikë e Seleksionimit dhe Ambalazhimit të Plastikës, Letrës, Qelqit, Metaleve si dhe Djegien e Mbeturinave Medicinale – Barnave me Afat të Skaduar (shtim i kodeve), në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Meeting ID: 821 4975 3249
Passcode: 12345678

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/82149753249?pwd=aUNYDoOAhKH5uXg1LTIQWPtKPXOuJG.1>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=princi>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
“Princi Company” Sh.p.k.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besmir Himaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Skender Jahë Kastrati” Malësi e Vogël Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Florent Zeqa shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Andi Rezniqui shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjimnazit “Gjon Buzuku” Prizren.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

F2.3/BNJ/KP/PT



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokollit 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokollit 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitën test me nr. protokollit 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 05.02.2026 me numër të protokollit 02/01/74 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, i cili i referohet Marrëveshjes në mes Komunës së Fushë Kosovës dhe KRM “Pastrimi”, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: Punëtor i Bartjes
Nr. i kërkuar: Tetëmbëdhjetë (18) pozita, NJO Fushë Kosovë në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës: KPJ/PT/NJOFSH/02/2026
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të caktuar (3 Muaj)

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- 1.2 Bënë zbrazen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- 1.3 Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- 1.4 Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- 1.5 Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës;
- 1.6 Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre ne kontejnerin përkatës;
- 1.7 Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- 1.8 Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët ti vendosë në vendin paraprak;
- 1.9 Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- 1.10 Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- 1.11 Për punën e tij i raporton Kryepunëtorit të Bartjes në Njësi Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

4.1 Dokumente të veçanta

- Patentë shoferi obligator për shoferët e kategorisë: B, C dhe C1

5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh. A.
- * në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

- * Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
- * Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbvlljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 07/02/2026 deri me datën 20/02/2026.
Koha e fundit e pranimi të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

9. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Abirapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

06 103 1832

06-02-2026

F2.3/BNJ/KP/PT

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokollit 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokollit 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitën test me nr. protokollit 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 05.02.2026 me numër të protokollit 02/01/74 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, i cili i referohet Marrëveshjes në mes Komunës së Fushë Kosovës dhe KRM "Pastrimi" të datë 24/06/2025 me nr. protokollit 02/01/476, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës:

Shofer i Kategorisë C dhe C1

Nr. i kërkuar:

Tre (3) pozita, NJO Fushë Kosovë në KRM "Pastrimi" SH.A

Numri i Referencës:

KPJ/PT/NJO/FK/03/2026

Koeficienti/Paga mujore:

Niveli XI

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:

Me kohë të caktuar (3 Muaj)

Përvoja e punës:

2 vite përvojë pune në fushën përkatëse

Shkollimi:

Shkollim i mesëm

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1.1 Nget automjetin sipas urdhërësës së punës në rajonin që i është përcaktuar nga udhëheqësi;

1.2 Është përgjegjës për udhëtoje nëpër rrugët dhe zona të caktuara për të mbledhur mbeturinat në mjediset e tyre të vendosura sipas planifikimit të kompanisë;

1.3 Kontrollon mjedisin për të identifikuar mbeturinat që duhet të merren dhe për të siguruar që puna bëhet sipas rregullave të shëndetit dhe sigurisë duke mos penguar komunikacionin;

1.4 Në bashkëpunim me udhëheqësin planifikon rrugët më të efektshme për të mbledhur mbeturinat nga zona që i është caktuar për të minimizuar humbjen e kohës dhe ruajtjen koston e udhëtimit;

1.5 Është përgjegjës për të siguruar që automjeti të jetë i sigurt dhe i gatshëm për përdorim përfshirë në kontrollin e nivelit të karburantit, kontrollin e presionit të gomave dhe kujdesin e përgjithshëm të automjetit.

1.6 Shoferi duhet të sigurojë që mbeturinat e cilësuar si shpërthyes të vendosen dhe të transportohen me kujdes të veçantë, duke zbatuar rregulloret mbi mbeturinat e rrezikshme;

1.7 Raporton çdo situatë të jashtëzakonshme që ndodh gjatë detyrës përfshirë emergjencë, dëmtime të automjetit ose shkelje të sigurisë;

1.8 Kujdeset dhe i respekton rregullat e komunikacionit rrugor;

1.9 Mbanë regjistrë të përgjegjshmërisë, në përputhje me rregulloret dhe politikat e kompanisë.

1.10 Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë;

1.11 Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njesisë Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,

✓ Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;

✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;

✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;

✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;

✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën

✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;

✓ Aftësia për të punuar vetë;

✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;

✓ Njohuri për sigurinë publike;

✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;

✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;

✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;

✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetim, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

4.1 Dokumente të vecanta

- Patentë shoferi obligator për shoferët e kategorisë: B, C dhe C1

5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.

* në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe

* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitën teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 07/02/2026 deri me datën 20/02/2026.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë

✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronit dhe individualisht.

9. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punes

• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së

- Letrën Motivuese

- Parapregaditje për intervistë

facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

